

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Salih Toplica-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit B. A. nga komuna e Gjilanit, për shkak të veprave penale vjedhje e pyllit nga neni 358.par.2.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.648/2014 të datës 11.11.2015., në seancën e mbajtur më 29.03.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit B. A. e paraqitur kundër aktgjyqimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.648/2014 të datës 11.11.2015.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.648/2014 të datës 11.11.2015. i dënuari B. A. është shpallur fajtor për dy vepra penale vjedhje e pyllit nga neni 358.par.2.të KPK dhe pasi që për veprën e parë penale i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) euro, ndërsa për veprën e dytë penale dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4

(katër) muajve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro, është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindë) euro, të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast të mos pagimit i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 29 euro për një ditë burgimi. Është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor ndërsa për realizimin e kërkesë pronësoro juridike e dëmtuara është udhëzuar në kontestin civil.

Kundër aktgjykimit në fjalë nuk është ushtruar ankesë dhe i njëjti ka marrë formën e prerë më datën 12.01.2016.

Kundër këtij aktgjykimi kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati E. Q. nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të ndryshohet ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.59/16 të datës 22.03.2016. ka propozuar që kërkesa të hedhet si e pasafatshme.

Gjykata Supreme gjeti se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor sepse konform dispozitës së nenit 433.par.2.të KPPK, nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë afati për ushtrimin e kërkesës rrjedh nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Në rastin konkret nuk është ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe ai është bërë i formës prerë me datën 12.01.2016., ashtu që kërkesa është ushtruar brenda afatit tre mujor, siç kërkon dispozita e nenit të njëjtë ligjor, e që propozimin e Prokurorit të Shtetit e bënë të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale në kërkesë theksohet se aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka arsye ligjore për faktet vendimtare, siç janë se pylltari i cili e ka paraqitur rastin, ka dhënë një emër tjetër të personit të cilin e ka zënë në pyll duke prerë dru, se i dënuari ka pas alibi sepse më datën 21.10.2010. ka qenë në Maqedoni e jo ne vendin e ngjarjes, po ashtu mungojnë arsye për llojin dhe sasinë e druve dhe aktgjykimi bazohet vetëm në një provë që është deklarata e pylltarit-dëshmitarit S. M.. Këto shkelje kanë ndikuar që gjykata në mënyrë të gabuar të vërtetojë gjendjen faktike e kjo për pasojë ka pas shkeljen e ligjit penal sepse në vend që të shpallet fajtor, i dënuari duhej të lirohej nga akuza.

Gjykata Supreme gjeti se për faktet vendimtare janë dhënë arsye ligjore.

Fakti i parë i cili potencohet në kërkesë është mungesa e arsyeve, gjegjësisht arsyetimi i mangët për identitetin e kryesit të veprave penale.

Nga aktgjykimi dhe nga shkresat e lëndës del se për veprat penale të cilat janë objekt i akuzës, është akuzuar personi me emrin B. (M.) H.. Në shqyrtimin gjyqësor i dënuari ka prezentuar letërnjoftimin nga i cili del se ai quhet B. (S.) A.. Për të sqaruar se personi i pranishëm në shqyrtim gjyqësor a është personi i cili është zënë në prerjen e druve në dy rastet kritike, është pyetur dëshmitari-pylltari S. M.. Ai ka deklaruar se ky është ai person, pra se këtë person e ka zënë në kryerjen e që të dy veprave penale. Dëshmitari ka sqaruar se personin ne fjalë e ka pyetur për emrin dhe mbiemrin, por ai i ka treguar vetëm emrin-se quhet B. dhe nuk ka deshtë të jep shënime tjetra, por ai ka pyetur në fshat dhe i është thënë se emri i babës së tij është M., e që më vonë është vërtetuar se ashtu quhet gjyshi e jo babai i tij, ndërsa mbiemri H.. Kjo ka qenë arsye që në fletëparaqitjen për dëmtimin e pyllit të shënojë këto shënime por në që të dy shqyrtime gjyqësore (aktgjykimi një herë është anuluar) të deklarojë me pa mëdyshje se ai është personi të cilin në dy raste e ka pa në vendet kritike duke prerë dru me sharë motorike dhe me traktor për transportimin e tyre. Gjykata e shkallës së parë ka kushtuar besim deklaratës së tij, duke gjetur se është e bindshme, se me të dënuarin nuk ka qenë në marrëdhënie të këqija dhe nuk ka pas arsye që rrejtshëm të dëshmojë për identitetin e tij.

Andaj, nuk mund të aprovohet pretendimi se aktgjykimit i mungojnë arsyet ose që ato janë të mangëta kur është fjala për vërtetimin e faktit të lartë cekur vendimtar.

Vlen të theksohet se në aktgjykimin paraprak të gjykatës së shkallës së parë P.nr.118/2013 të datës 24.10.2013. është thënë se kjo çështje penale është zhagitur për shkak të dhënies të shënimeve jo të sakta personale nga i dënuari dhe se e njëjta ka ndodhur edhe në dy lëndë tjera të asaj gjykate kundër të njëjtit të pandehur për vepra të njëjta penale.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka aprovuar as alibinë-mbrojtjen e të dënuarit se më datën 21.10.2010. ka qenë në Maqedoni, që vërtetohet nga vula në pasaportën e tij, për arsye se pylltari ka deklaruar se atë ditë e ka takuar në vendin e ngjarjes duke prerë dru, por edhe për arsye se vula në pasaportë nuk shihej mirë (Gjykata Supreme konstatojë se vula jo vetëm se është tërësisht e paqartë dhe nuk shihet data e hyrjes në shtet tjetër-shihet data 21.10. por jo edhe viti, por se menjëherë afër saj është edhe një vule tjetër jo shumë e qartë, e datës 21.10. 2010. që do të mund të tregojë se i dënuari të njëjtën ditë është kthyer në Kosovë). Konkludimi i gjykatës së shkallës së parë ka qenë se edhe në raste se është fjala për datën 21.10.2010., i dënuari ka mundur që të njëjtën ditë të kalojë kufirin dhe të kthehet, pra të jetë në vendin e ngjarjes. Duhet të theksohet edhe fakti se i dënuari tani për herë të parë është thirrur në alibi edhe pse ka pasur mundësi që këtë të bëjë gjatë tërë procedurës penale.

Në aktgjykimin e kundërshtuar janë dhënë edhe arsye për veprimet konkrete inkrimuese e të dënuarit që është prerja e druve me sharrë motorike në pyllin shoqëror, si dhe për llojin e druve dhe sasinë e tyre, e cila është vërtetuar në bazë të vrojtimit të pylltarit dhe llogaritjes së sasisë nga tekniku i pylltarisë, ashtu që pretendimet në kërkesë se aktgjykimi në këtë pikëpamje ka mangësi, nuk mund të aprovohen.

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk bazohet në një provë të vetme ose duke i dhënë rëndësi vendimtare kësaj prove që është deklarata e dëshmitarit-pylltarit S. M. sepse përveç asaj si prova janë administruar edhe fletëparaqitjet për dëmtimin e pyllit të datave 21.10.2010. dhe 24.10.2010., si dhe pasaporta e të dënuarit. Përveç kësaj dëshmia e

dëshmitarit është kundërshtuar në shqyrtimin gjyqësor ashtu që nuk ka bazë pretendimi për shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 262. lidhur me nenin 384.par.1.pika 8. apo 384.par.2.të KPPK.

Sa i përket pretendimit se pasi të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, gjykata e shkallës së parë ka bërë lëshim kur nuk e ka pyetur për zëvendësimin e tij me dënim me gjobë, Gjykata Supreme konstatojë se konform nenit 47.të KPK kjo është vetëm mundësi e jo imperativ ligjor, ashtu që as ky pretendim nuk u aprovua.

Pasi që për faktet vendimtare të vërtetuara në mënyrë të drejt dhe të plotë janë dhënë edhe arsye ligjore, me shpalljen fajtor e të dënuarit për veprat penale që i vihen në barë, drejt është aplikuar edhe ligji penal dhe janë të pabazuara pretendimet që duhej të lirohej nga akuza.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 86/2016, më 29.03.2016.

Proçesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka